VENDIM
Nr. 847, datë 24.12.2019

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 343, DATË 8.4.2009, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR MËNYRAT DHE PROCEDURAT E RAPORTIMIT TË AUTORITETEVE LICENCUESE DHE/OSE MBIKËQYRËSE"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 24, pika 5, e 28, pika 1, të ligjit nr. 9917, datë 19.5.2008, "Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 343, datë 8.4.2009, të Këshillit të Ministrave, bëhen shtesat dhe ndryshimet, si më poshtë vijojnë:

a) në pikën 1 bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

i. pas nënndarjes "iii", të shkronjës "b", shtohen nënndarjet "iv" dhe "v", me këtë përmbajtje:

"iv. shoqëritë administruese të sipërmarrjeve të investimeve kolektive dhe fondeve të pensioneve, si dhe agjentët e tyre;

v. çdo person fizik ose juridik, i cili merret me ofrimin e shërbimeve të mjeteve virtuale.";

ii. në shkronjën "c", emërtesa "Ministria e Financave" zëvendësohet me fjalët "ministria përgjegjëse për financat";

iii. në shkronjën "e" emërtesa "Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit" zëvendësohet me fjalët "ministria përgjegjëse për infrastrukturën";

iv. nënndarja "ii", e shkronjës "e", shfuqizohet;

v. në shkronjën "f" emërtesa "Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve" zëvendësohet me fjalët "ministria përgjegjëse për kulturën";

vi. shkronja "g" ndryshohet si më poshtë vijon:

"g. organet tatimore për organizatat jofitimprurëse.";

b) pika 2 ndryshohet si më poshtë vijon:

"2. Autoritetet licencuese dhe/ose mbikëqyrëse mbikëqyrin, nëpërmjet inspektimeve, përputhshmërinë e veprimtarisë së subjekteve me detyrimet e përcaktuara në ligjin nr. 9917, datë 19.5.2008, "Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizimit.".

2. Ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave dhe autoritetet licencuese dhe/ose mbikëqyrëse për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletore Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama